

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Mobileri Menga”**

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar;  
Sot, më datë 28.02.2024 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “Mobileri Menga”, Themeluesit e shoqërisë janë shtetasit:

1. Z. Ndue Preng Menga i datëlindjes 13.06.1966, lindur në Stojan, dhe banues në, Lagjia Nr.17, Rruga Glaukia, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal (ID) G60613051A.
2. Z. Florind Ndue Menga i datëlindjes 17.04.2001, lindur në Durrës, dhe banues në, Lagjia Nr.17, Rruga Glaukia, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal (ID) K10417064V.

Shoqëri e cila do të funksionojë në bazë të këtij, **AKT-THEMELIMI**.

**LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË**

**NENI 1**

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është “Mobileri Menga”. Emri tregtar i kësaj Shoqërie është “Mobileri Menga”.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**NENI 2**

Objekt i Shoqërisë Tregtare “Mobileri Menga” është:

Prodhim, shitje të të gjitha llojeve të mobiljeve. Veprimtari në fushën e ndërtimit, investimit, investitor, investime strategjike. Import - Eksport të mallrave të ndryshëm të reja dhe të përdorura, mallra të konsumit si ato ushqimore dhe ato industriale.

**KOHËZGJATJA**

**NENI 3**

Shoqëria Tregtare “Mobileri Menga”, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.  
Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

FLORIND Menga  


Ndue Menga  


## SELIA E SHOQËRISË

### NENI 4

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare "Mobileri Menga", e ka vendodhjen e saj në, Zona Kadastrale 8513, Numër Pasurie 8/235 Lagjia Nr.17, Rruga Glaukia, Durrës.

## REGJIMI JURIDIK

### NENI 5

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.  
Shoqëria "Mobileri Menga" fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "Mobileri Menga", përbëhet prej 100,000.00 (Një qind mijë) lekë.

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e:

1. Z. Ndue Preng Menga: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 51,000.00 (pesëdhjetë e një mijë) lekë.
2. Z. Florind Ndue Menga: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 49,000.00 (dyzet e nëntë mijë) lekë.

## ADMINISTRIMI

### NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar është Z. Florind Ndue Menga me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

## TË DREJTAT E SHOQËRISË

### NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit.  
Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.  
Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

Florind Menga



Ndue Preng



## VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

### NENI 9

Viti financiar i shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

### SHPËRNDARJA E FITIMIT

### NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.  
Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### LIKUJDIMI

### NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likujdim e sipër”.  
Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa vetejtje.

### ORTAKËT

#### E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Mobileri Menga”

Ndue Preng Menga

Ndue Menga



Florind Ndue Menga

FLORIND Menga

